

VENDIM
Nr. 576, datë 3.8.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 249, DATË 1.7.1980, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR VËNIEN NË MBROJTJE SHTETËRORE TË LAGJEVE DHE
TË ANSAMBLEVE ARKITEKTONIKO-HISTORIKE NË QYTETET KORÇË,
ELBASAN, SHKODËR, VLORË, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 9084, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e vendimit nr. 249, datë 1.7.1980, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
 2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi